

KUSHTET E PËRDORIMIT TË FAQES- FAQET E REGJISTRIMIT NË MIKROFAQE

Pajisjet Samsung Galaxy S9 ose S9+ të blera nga 23 prill deri 15 jula 2018.

Para fillimit të procesit të regjistrimit për pajisjet Samsung Galaxy S9 ose Galaxy S9+ të blera nga 23 prilli deri më 15 jula 2018, ju lutemi lexoni kushtet e përdorimit të faqes - mikrofaqe për regjistrimin e këtyre pajisjeve (në tekstin në vijim referuar si 'Termat'):

1. Samsung Electronics Austria GmbH (në tekstin në vijim "Samsung") po organizon promovimin e pajisjeve Samsung Galaxy S9 dhe S9+ si pjesë e së cilës është edhe një dhuratë shtesë: Karikuesi pa tel dhe 1 vit garanci në rast të dëmtimit të ekranit.

Karikuesi pa tel do të jepet si dhuratë. Për kushtet e promovimit, sigurimit dhe regjistrimit www.samsungsp.eu

2. QËLLIMI DHE KOHËZGJATJA E REGJISTRIMIT TË PAJISJEVE

Samsung organizon regjistrimin e pajisjeve Samsung Galaxy S9 ose S9+ të blera nga data 23 prill deri më 15 jula 2018, i cili bëhet përmes një faqeje të internetit dedikuar posaçërisht për këtë qëllim - www.samsungsp.eu. Kohëzgjatja e procesit të regjistrimit është nga data 23 prill 2018 deri më 15 jula 2018 dhe është e mundur të regjistrohen pajisjet e Samsung Galaxy S9 ose S9+ të blera vetëm nga data 23 prill deri më 15 jula 2018. Çdo klient që regjistron pajisjen e tij sipas Termave në faqet/mikrofaqet e internetit të përgatitura posaçërisht për këtë qëllim, do të marrë një karikues pa tel në adresën e tij, pa kosto shtesë në periudhën prej 20 ditësh pune nga regjistrimi i suksesshëm i pajisjes.

Për përfitimet e sigurimit shikoni detajet në faqen e internetit www.samsungsp.eu

3. KUSHTET PËR REGJISTRIM

Të drejtë për të regjistruar pajisjen Samsung Galaxy S9 ose S9+ e kanë të gjitha pajisjet Samsung Galaxy S9 ose S9+ në territorin e Republikës së Kosovës, të blera nga data 23 prill deri më 15 jula 2018 në dyqanet e autorizuar nga Samsung:

Neptun Kosovë, NTP Gama, Ipko

4. PROCEDURA E REGJISTRIMIT TË PAJISJES

Klienti duhet të regjistrojë pajisjen e blerë nga data 23 prilli deri më 15 jula 2018, në mënyrë që të ketë të drejtë të marrë një karikues pa tel dhe një vit garanci në rast të dëmtimit të ekranit. Ky regjistrim duhet të kryhet nëpërmjet mikrofaqes në faqen zyrtare të internetit www.samsungsp.eu

Procesi i regjistrimit kërkon shënimin e të dhënave personale të klientit për regjistrim të suksesshëm.

Do të mblidhen të dhënat personale të klientëve si në vijim: emri, mbiemri, adresa e e-mailit të blerësit, adresa e plotë e blerësit (kështu mund të dorëzohet karikuesi pa tel), numri IMEI i pajisjes së blerë si dhe ngarkimi i faturës fiskale nga vendi i blerjes. Përpos të dhënave personale të lartpërmendura, mund të kërkohen edhe të dhëna për modelin e mëparshëm të telefonit të konsumatorit, si dhe të dhënat për moshën e tij, megjithatë, mos shënimi i këtyre të dhënave shtesë nuk do të ketë ndikim. Duke klikuar butonin për të procesuar të dhënat, klienti dorëzon të dhënat e tij tek Samsung për të ri/kontrolluar nëse blerja është e vlefshme dhe është kryer brenda afatit të planifikuar - nga data 23 prill deri më 15 jula 2018 ose deri në përfundim të stokut në dispozicion dhe klienti jep gjithashtu konfirmimin e tij/saj për përdorimin e të dhënave personale të tij/saj në përputhje me këto terma dhe kushte.

Nëse blerja e pajisjes është e saktë dhe e konfirmuar, blerësi do të pranojë në adresën e tij karikuesin pa tel në periudhë prej 20 ditë pune nga dita e regjistrimit të suksesshëm të pajisjes. Klienti do të njoftohet për këtë, duke dërguar një mesazh në adresën e postës elektronike të deklaruar në regjistrim. Konfirmimi i Termave dhe Kushteve është i detyrueshëm në mënyrë që procesi të përfundojë.

Blerësi gjithashtu mund të kontrollojë në mënyrë të pavarur statusin e pajisjes, duke shënuar adresën e e-mailit të regjistrimit dhe fjalëkalimin (kodin) e marrë gjatë regjistrimit.

5. PËRDORIMI I TË DHËNAVE PERSONALE

Të dhënat personale të klientëve, që regjistrojnë të dhënat e tyre në një faqe – mikrofaqe, do të grumbullohen dhe përpunohen në përputhje me politikat e Samsung për privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale dhe me këto terma dhe kushte, si dhe me rregulloret përkatëse të Republikës së Kosovës për mbrojtjen e të dhënave personale.

Të dhënat personale të klientit do të mblidhen për të kontrolluar nëse janë plotësuar kushtet për pjesëmarrje në këtë promovim, si dhe për të përcaktuar adresën e saktë për dërgimin e karikuesit pa tel.

Të dhënat personale të klientit të mbledhura në kuadër të këtij promovimi, do të jenë në dispozicion për subjektet në vijim:

- Samsung Electronics Austria GmbH, në cilësinë e Mbledhësit të të Dhënave.
- Kompania e sigurimeve Uniqa, në cilësinë e Përpunuesit të të Dhënave

Mbledhësi i të Dhënave dhe Përpunuesi i të Dhënave, i trajtojnë këto të dhëna në përputhje me politikat e Samsung për privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale dhe bazuar me rregulloret përkatëse të Republikës së Kosovës dhe nuk i lënë të dhënat në dispozicion të palëve të treta.

Grumbullimi i të dhënave personale të klientit në kuadër të këtij promovimi është vullnetar. Nëse klienti vendos të mos ndajë të dhënat e tij personale me Samsung, ai nuk do të ketë të drejtën të marrë pjesë në këtë promovim dhe as të marrë dhuratë karikuesin pa tel.

Nëse të dhënat personale të klientit nuk janë të plota, të pasakta ose të papërditësuara, me kërkesë të klientit (pronari i të dhënave), Mbledhësi i të Dhënave duhet të shtojë, ndryshojë ose fshijë të dhënat personale të klientit.

6. E DREJTA PËR TË NDRYSHUAR KUSHTET E PËRDORIMIT

Samsung rezervon të drejtën për të ndryshuar këto Terma dhe Kushte në çdo kohë, me detyrimin për t'i bërë këto ndryshime të njohura publikisht pa vonesë. Nëse këto ndryshime përfshijnë një ndryshim të kushteve të përdorimit të të dhënave personale, Samsung do të kërkojë pëlqimin e klientëve që kanë ndarë të dhënat e tyre personale në kuadër të këtij promovimi.